



KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE
Drejtoria e Ligjshmërisë

Data	
Nr. Prot	

RELACION
PËR
PROJEKTVENDIMIN
PËR
SHPALLJEN E REZULTATIT PËRFUNDIMTAR TË ZGJEDHJEVE TË PJESSHME PËR
KRYETAR TË BASHKISË KUKËS TË DATËS 24 SHTATOR 2023

I. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJSLACIONIN NË FUQI

Neni 20, pikat 2, shkronja “d”, e 3 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, parashikojnë kompetencën e Komisionit Rregullator për të shqyrtuar dhe miratuar projektaktet e përgatitura nga administrata e KQZ-së për rezultatin përfundimtar të zgjedhjeve në shkallë vendi në përputhje me këtë ligj.

Referuar nenit 167 të Kodit Zgjedhor, rezultati përfundimtar i zgjedhjeve shpallet nga KQZ-ja jo më vonë se 5 ditë nga data e shpalljes së rezultatit për shpërndarjen e mandateve për çdo zonë zgjedhore, dhe pasi të kenë përfunduar procedurat e ankimit, sipas këtij Kodi.

II. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTVENDIMIT

Në mbështetje të Dekretit nr. 186, datë 11.8.2023, të Presidentit të Republikës, “Për caktimin e datës së zhvillimit të zgjedhjeve të pjesshme për Kryetar të Bashkisë Kukës”, u zhvilluan zgjedhjet e pjesshme të datës 24 Shtator 2023.

Bazuar në nenin 166, pika 1, të Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë, Kryetar Bashkie zgjidhet kandidati që fiton numrin më të madh të votave të vlefshme të zgjedhësve që kanë votuar në njësinë vendore përkatëse.

Në mbështetje të nenit 33, shkronja “g”, Komisioni i Zonës së Administrimit Zgjedhor nr. 11, me vendimin nr. 17, datë 26.09.2023, ka shpallur fitues z. Albert Bislim Halilaj, si Kryetar i Bashkisë Kukës, të propozuar nga subjekti zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë”.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, me vendimin nr. 786, datë 4.10.2023 “Për dhënien e mandatit të Kryetarit të Bashkisë Kukës, Qarku Kukës, z. Albert Bislim Halilaj, të propozuar nga subjekti zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë”, për zgjedhjet e pjesshme të datës 24 Shtator 2023”, i ka dhënë

mandatin e Kryetarit të Bashkisë Kukës, Qarku Kukës, z. Albert Bislim Halilaj, të propozuar nga subjekti zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë”.

Komisioni Rregullator, pas dhënies së mandatit nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në mbështetje të nenit 20, pika 2, shkronja “d” dhe nenit 167 të Kodit Zgjedhor, shpall me vendim rezultatin përfundimtar të zgjedhjeve.

Për sa më sipër në këtë relacion, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve i propozon Komisionit Rregullator për shqyrtim dhe miratim projektvendimin “Për shpalljen e rezulttit përfundimtar të zgjedhjeve të pjesshme për Kryetar të Bashkisë Kukës të datës 24 Shtator 2023”.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioni Rregullator

Data: .2023

Nr:

Ora:

PROJEKTVENDIM

PËR

**SHPLLJEN E REZULTATIT PËRFUNDIMTAR TË ZGJEDHJEVE TË PJESHME PËR
KRYETAR TË BASHKISË KUKËS TË DATËS 24 SHTATOR 2023**

Në mbështetje të nenit 20, pikat 2, shkronja “d”, e 3, dhe nenit 167, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, Komisioni Rregullator

VENDOSI:

1. Të shpallë rezultatin përfundimtar të zgjedhjeve të pjesshme për Kryetar të Bashkisë Kukës të datës 24 Shtator 2023, si më poshtë:
 - a) z. Albert Bislim Halilaj, kandidat fitues për Kryetar të Bashkisë Kukës, Qarku Kukës, i propozuar nga “Partia Socialiste e Shqipërisë”.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor Gjyqësor pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, brenda 5 (pesë) ditëve nga shpallja e tij.

Ilirjana NANO Kryetar

Arens ÇELA Anëtar

Dritan ÇAKA Anëtar

Helga VUKAJ Anëtar

Muharrem ÇAKAJ Anëtar

Data: .2023 Nr:
Ora:



“Për shpalljen e rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve të pjesshme për Kryetar të Bashkisë Kukës të datës 24 Shtator 2023”